

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

**30.03.2023
Ora 13:11**

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr.39, objekti: Ankim administrativ ndaj vendimit të KZAZ nr. 82, Dropull, me ankues "Nisma Thurje".

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin Lako (on-line), Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Parti politike: Nisma Thurje (E. Shabani)

Të tjerë: KRIIK, KZAZ-ja nr.82, Bashkia Dropull

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve, deklarojmë të hapur seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore me numër 39, datë 29 mars 2023 të paraqitur nga zoti Kosta Garo kandidat për kryetar i Bashkisë Dropull dhe zoti Endrit Shabani Kryetar i Partisë Nisma Thurje, kundër vendimit numër 10 datë 28.03.2023 të KZAZ-së numër 82 në Bashkinë Dropull. Sipas shortit hedhur në KQZ relator i kësaj çështje do të jem unë Elvis Çefa. Do të verifikojmë fillimisht prezencën. Është e plotë trupa e KAS-it duke përfshirë dhe kolegun tonë i cili po na ndjek online për shkak të pamundësisë së paraqitjes fizike sot këtu, është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe administrata e KQZ-së, është prezent përfaqësuesi i Nismës Thurje, ju lutem mikrofonin edhe emrin:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. E. Shabani: Endrit Shabani!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Zoti Garo është prezent?

Z. K. Garo: Po, prezent!

Z. E. Çefa: Atëherë, përpara se të fillojmë ndonjë kërkesë paraprake a keni? Duke përfshirë edhe kërkesat për përjashtim të ndonjë antari të KAS-it për konflikt interesi apo diçka e tillë?

Z. E. Shabani: Jo nuk kemi!

Z. E. Çefa: Nuk keni, kolegët ndonjë deklarat për konflikt interesi nuk kanë, kështu që unë besoj se jemi në kushte që mund të vazhdojmë pa pengesa. Besoj e keni parasysh që sot është aktualisht është vetëm seanca paraprake. Sot është vetëm seanca paraprake do të diskutojmë elementët e formës përmbajtjes ankimit dhe më pas do të kemi seancën e themelit për gjykimin e çështjes në themel. Ndërkohë, kolegët më kujtojnë kemi përfaqësues të KZAZ-së këtu?

Z. G. Dushi: Po!

Z. E. Çefa: Ju lutem prezantohuni.

Z. G. Dushi: Gligor Dushi jam kryetar i KZAZ-së nr. 82,

Z. E. Çefa: Kryetari po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. G. Dushi: Përveç meje janë edhe antarët.

Z. V. Xhako: Vasil Xhako, anëtar i KZAZ-së nr. 82.

Znj. K. Zhaku: Kristina Zhaku, anëtare e KZAZ-së nr. 82.

Z. E. Çefa: Ju meqënëse s'ju pyetëm? Po...

Z. V. Pirali: Vangjel Pirali, anëtar i KZAZ-së nr. 82.

Z. E. Çefa: Faleminderit, edhe ju keni të drejtën për kërkesa paraprake eventualisht për verbal na duhet ti rikujtojmë, dakord atëherë. Për të relatuar shkurtimisht çështjen duhet të ja jap fjalen Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së zotit Ylli Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 39, me ankues Partia “Nisma Thurje” kundër vendimit numër 10 të KZAZ-së nr. 82 e cila nuk ka regjistruar kandidatin për kryetar të Bashkisë Dropull, zotin Kosta Thoma Garo. Referuar nenit 21 pika 1 germa “c”, subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” është ankuar kundër këtij vendimi duke mos qenë dakord dhe nga verifikimi i elementëve të formës dhe përmbajtjes konstatohet se i plotëson elementët e parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Pasi është kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimeve dhe neni 21 i Kodit Zgjedhor parashikon që KAS-i është kompetent për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të KZAZ-së. Legjitimimi i ankuesit, ka interes të ligjshëm për mos regjistrimin e tij, si dhe ka respektuar afatet ligjore të parashikuara në ankim. Kështu që ne propozojmë të kalojë për shqyrtim në seancë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. E. Çefa: Ju, faleminderit! Ankuesit për këtë fazë të procedimit kemi diçka për të thënë? Besoj që kërkoni edhe ju që çështja të kalojë në seancë shqyrtimi nga KAS-i apo jo? Përfaqësuesit e KZAZ-së?

Z. G. Dushi: Dakord!

Z. E. Çefa: Dakord, atëherë.

Z. K. Bele: Më fal, kisha vetëm një pyetje, ju lutem që s'ka lidhje me këtë. Dokumentacion tjetër kemi nga KZAZ-ja të administruar në këtë fazë, që është depozituar veç këtij që na keni vënë para?

Z. Y. Merkaç: Kemi vendimin numër 10, kemi procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit: deklarata e kandidatit për hapje llogarie, një vërtetim të kandidatit për hapje llogarie, kërkesa për regjistrim kryetari. I keni apo jo këto? Jetëshkrimin e kandidatit, kemi dhe listën mbështetëse të kandidatit.

Z. K. Bele: Pavarësisht se këto janë të themelit, por në duhet t'i kishim dhe në këtë fazë.


Z. Y. Merkaç: Po, po në qoftëse nuk i keni do t'jua plotësojmë direkt.

Z. E. Çefa: Po, zoti Shabani.

Z. E. Shabani: Atëherë, së bashku me ankimin ne kemi depozituar të gjithë dokumentacionin që u përmënd nga Sekretari Përgjithshëm. Listën e 125

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

nënshkruesve dhe fotokopjet e kartave të tyre të indetitetit të nënshkruara. Këto janë depozituar në KQZ., 215.

Z. L. Braho: Këto nuk janë depozituar në KZAZ që i keni ju?

Z. E. Shabani: KZAZ-ja ka rikthyer të gjithë dokumentacionin, përfshirë kartat, nënshkrimet, gjithçka.

Z. L. Braho: I ka rikthyer?

Z. E. Shabani: I ka rikthyer kandidatit dhe ne i kemi depozituar në KQZ. Qartazi KZAZ-ja nuk i ka, megjithëse procesverbali vërteton që këto janë dorëzuar në KZAZ dhe i janë rikthyer pastaj përsëri kandidatit.

Z. I. Rusmali: Meqenëse jemi në kuadër të qartësimit të këtyre gjërave dokumentave procedurale. Vendimi juaj nr. 10 nuk e përmënd shkakun. Pse ju keni refuzuar pranimin e dokumentacionit? Mund të na thoni cili është shkakun?

Z. G. Dushi: Shkakun është vendimi që është marrë në datën 28. Jo nuk e keni ju atje, është te libri i protokollit të mbledhjeve që mban KZAZ-ja. E keni ju këtë?

Z. I. Rusmali: Çfarë është ky, vendimi?

Z. G. Dushi: Po.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. I. Rusmali: Po vendimi nuk thotë, pse refuzohen. Pse e keni refuzuar?

Z. G. Dushi: Do t'jua sqaroj.

Z. I. Rusmali: Nuk na e thoni dot me dy fjalë që të kuptojmë gjënë?

Z. G. Dushi: Është në kundërshtim me ligjin 70, që thotë procedura dhe nenin 68.

Z. L. Braho: Po, pra aty ka shumë pika. Për cilën nga pikat? Kush ka qenë shkaku? Na e thuaj me fjalë jo me nen. Kush ka qenë shkaku që është vendosur që të mos regjistrohet?

Z. G. Dushi: Shkaku i mospranimit të tyre është mos dorëzimi nga ana e subjektit të listave të fotokopjeve të personave që kanë firmosur listat mbështetëse të firmosura në çdo fotokopje, si dhe paligjshmërinë që kanë në personat te listat mbështetëse.

Z. L. Braho: E keni verifikuar në seancë publike ju paligjshmërinë?


Z. G. Dushi: Po!

Z. I. Rusmali: Keni mbajtur një procesverbal për verifikimin?

Z. G. Dushi: Është mbajtur nëprotokollin e mbledhjes.

Z. I. Rusmali: Dmth, kjo është në Librin e protokollit që ndodhet në..?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. G. Dushi: Në KZAZ-në Dropull, po!

Z. E. Shabani: Ju lutem, mund të bëj një prapësim? Ky është procesverbali i dorëzimit, e keni aty në dosje, të dokumentave të kandidimit të nënshkruar nga zoti në fjalë, zoti Grigor Dushi, i cili nuk ka asnjë pretendim për mungesë dokumentacioni. Pika e parë e nënshkruar thotë:...

Z. I. Rusmali: Të lutem, të mos i futemi themelit...

Z. E. Shabani: Dakord!

Z. I. Rusmali:...se është çështje themeli dhe ne ndaj mezi po i bëjmë pyetjet. Kjo e gjitha ishte për të sqaruar, në qoftë se ne do të shqyrtojmë kush është problemi këtu, dokumenti zyrtar që ne na duhet që ta marrim dhe të shohim, është ai që nuk ndodhet këtu. Kjo na krijon ne këtë vështirësi.

Z. G. Dushi: E kemi me vete libri e protokollit.


Z. I. Rusmali: Ju thatë është në Dropull.

Z. G. Dushi: Jo, jo e kam me vete këtu.

Z. I. Rusmali: A mundet t'i bëjmë fotokopje këtij procesverbali?

Z. G. Dushi: Patjetër, pa dyshim!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. E. Çefa: Atëherë, do të administrohet si provë, zoti Sekretar i Përgjithshëm!

Z. L. Braho: Vulën e KZAZ-së e keni me vete?

Z. G. Dushi: KZAZ-ja nr. 82, përbëhet nga 7 anëtarë, por janë vetëm 4 anëtarë të emëruar. Tre anëtarët e tjerë dhe sekretari nuk janë emëruar ende. Sot jemi ende pa sekretar, pra pa vulë.


Z. L. Braho: Pra ju s'keni vulë?

Z. G. Dushi: Po, as sekretar.

Z. L. Braho: KAS-i i konsultuar në vend, vendosi: pranimin e kërkesës, kalimin për shqyrtim në seancë themeli të kërkesës ankimore nr. 39. Seanca do të zhvillohet ditën e hënë në datën 3 prill, ora 12:30, këtu në ambjentet e KQZ-së. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 36

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

**30.03.2023
Ora 13.53**

RENDI I DITËS


Projektvendim "Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 38, datë 29.03.2023, me kërkesë "Qëndresa Qytetare" ndaj vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve."

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike** S'ka

Z. L. Braho: Çelim seancën e verifikimit të kushteve formale të kërkesës ankimore nr. 38, të paraqitur nga ankuesi Qëndresa Qytetare, e cila është protokolluar pranë KQZ-së në datë 29 mars 2023, me objekt: kundërshtimin e vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ankimuesit nuk janë të pranishëm. Është prezente administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Atëherë, me pak fjalë zoti Sekretar i Përgjithshëm në lidhje me elementët e parashikuar në nenet 129 dhe 130 për sa i përket kësaj kërkesë ankimore.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Në datën 24.03.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim denoncimet për shkeljet administrative të ndodhura në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Me vendim 199 ka vendosur ndër të tjera “pushimin e procedimit administrativ ndaj, shkronja “p”e vendimit, zonjës Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim ankuesi Qëndresa Qytetare, e cila pretendon se ka pas shkelje dhe ka veprimtari të ndaluara. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson elementët formalë të kërkesës, parashikuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor dhe i propozojmë KAS-it të kalohet për shqyrtim. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim administrativ të Kërkesës Ankimore nr. 38 të protokolluar në datën 29.03.2023, me ankues Qëndresa Qytetare.
- Caktohet data 4 prill 2023, ora 12:30, për zhvillimin e seancës së shqyrtimit administrativ. Kjo seancë deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 35

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

**30.03.2023
Ora 14.02**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore nr. 40, datë 30.03.2023, të z. Mehmet Nelaj me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 17, datë 27.03.2023, të KZAZ nr. 90, Sarandë”.


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike** S’ka

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 40. Jemi në shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë për të parë pajtueshmërinë me elementët e formës, pa i hyrë përmbajtjes. Verifikojmë prezencën. KQZ-ja prezent, KAS gjithashtu në kourum. Nuk ka palë të interesuara për procesin. Në këtë fazë kërkesa paraprake nuk ka. Sekretari i Përgjithshëm shkurtimisht në lidhje me plotësimin apo jo të elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur Kërkesa Ankimore nr. 40, me ankues zotin Mehmet Nelaj kundër vendimit nr. 17, datë 27.03.2023, të KZAZ nr. 90, Sarandë, i cili nuk e ka regjistruar si kandidat për anëtar të këshillit bashkiak. Nga verifikimi paraprak i kërkesës ankimore konstatohet se i plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes, parashikuar në nenin 130 të Kodit

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2023*

Zgjedhor dhe i propozojmë KAS-it të kalohet kërkesa ankimore në seancë shqyrtimi.
Faleminderit!

Z. K. Bele: KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim administrativ të Kërkesës Ankimore nr. 40.
- Seanca e shqyrtimit të Kërkesës Ankimore nr.40 do të jetë nesër, ditën e premte, data 31 mars 2023, ora 14:00.
- Të merren masa për të njoftuar palët për çfarë u vendos.

Seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 37

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

